



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

R A P O R T I P U N Ě S (Prill – Maj – Qershor)

- Është realizuar “Analiza e Fizibilitetit” dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për projektin që do të zhvillohet me partneritet publiko-privat të Parkingut nëntokësor dhe është aprovuar nga komiteti për partneritet publiko-privat, së shpejti do të fillojmë me procedura të tjera për zbatimin e këtij projekti.
- Kemi përfituar projekte për Komunën nga:

MAPL me UN-Habitat dhe MMPHI në thirrjen “Instrumenti i Investimeve Publike (CIF)” me projektin:

- ✓ *Podujeva për Efiqencë dhe zhvillim efikas*

Ministria e Zhvillimit Rajonal në thirrjen “Programi për Zhvillim Rajonal 2022 (Investimet Kapitale)” me projektet:

- ✓ *Ndërtimi i Stacionit të Autobusëve, faza e parë (I)*
- ✓ *Kërkesa për vazhdimin e projektit të vitit 2021 - Ndërtimi i urave në fshatrat Sfeqël, Bajqinë dhe Gllamnik.*

- Është realizuar (përmbyllur) projekti në koordinim me BSCK si rezultat i memorandum bashkëpunimit të lidhur në projektin: “Aftësi dhe Shkathtësi të buta për Ndërmarrësi dhe Marketing Digjital”, përkatësisht furnizimi me pajisje dhe implementimi te përfituesit, janë 14 përfitues të ndarë në sektorë të ndryshëm si: Gastronomi, Autolarje, Zdrukthëtari, Rrobaqepësi, Berber etj.
- Është lidhur kontrata në projektin për “ Hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 ”, tani është në fazën e mbledhjes së të dhënave.
- Është lidhur kontrata dhe kanë filluar punët në projektin “Analiza e Fizibilitetit të Zonës Industriale – Parkut Industrial ”
- Është mbajtur punëtorja “Ndërmarrësi dhe shkathtësit të buta” e dedikuar për personat e riatëdhësuar dhe gratë, trajnimi është mbajtur nga D&D Business Support.

- Është në fazën finale (përfundimtare) realizimi i projektit “Botime dhe publikime” përkatësisht Katalogu i parcelave/pronave për dhënie në shfrytëzim dhe platforma elektronike.
- Ka përfunduar të gjitha procedurat e prokurimit dhe është në prag të lidhjes së kontratës projekti “Investime në infrastrukturën e turizmit”, përkatësisht rregullimi i Parkut të Paqës në qytet.
- Ka filluar realizimi i projektit/festivalit veror “Ditët e Diasporës” janë vendosur 6 shtëpiza druri në sheshin “Ali Ajeti”, është publikuar thirrja për aplikim për dhënie në shfrytëzim të këtyre shtëpizave.
- Është në proces draftimi i Rregullorës për Orarin e Punës të Bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, është ngritur grupi punues në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor të Kuvendit Komunal.
- Është përfunduar pregaditja e materialit për realizimin e projektit “Anketa me komunitetin e Biznesit” me fokus gjendja në tregun e punës.
- Është në proces themelimi i Parkut të biznesit, ku jemi duke zhvilluar procedurë për shpronsim me AKP-në.
- Është inicuar procedura për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) në Komunën e Podujevës.
- Sektori i regjistrimit të Bizneseve ka shqyrtuar më shumë se 200 lëndë/kërkesa të dorëzuara në drejtori.
- Janë ofruar këshilla dhe asistencë për bizneset, të rinjët dhe qytetarët për fushën dhe kompetencën që ne mbulojmë.
- Janë mbajtur Takime dhe Punëtori të ndryshme me:
 - Kosovo Local Government - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale
 - MAPL – UN-Habitat – MMPH
 - AZHR – MZHR
 - WWFF Adria dhe MMPHI
 - Asociacioni i Komunave të Kosovës
 - Të tjera...

08.07.2022

Drejtor i DPZHE:
z. Vigan Salihu

